

- Ritjen e lejuar te transfetes se pakushtezuar te parashikuar me Udhëzimin e Ministrise se Financave nr 6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e tavanëve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”
- Programi i aktiviteteve per vitin 2018 per institucionin e Keshillit te Qarkut te lidhura me objektivat e zhvillimit te qeverisjes qendrore.
- Parashikimi I pritshem I kontratave per implementimin e projekteve te frituara me fonde te Bashkimit Europian ne kuader te Programeve te Bashkepunimit nderkufitar IPA CBC Greqi – Shqiperi 2014-2020.
- Normativat e lejuara te shpenzimeve te miratuara me akte ligjore dhe nenligjore.

Programi	Emertimi i të Ardhurave	Fakti 2016	Fakti 2017	Plani për vitin 2018
01110	Të ardhurat e veta	9137439	1730991	7800000
01110	Transferta e pakushtëzuar	46495324	47421446	49489605
01110	Transf. të kushtëz. F. Zhvillim I Rajoneve	900010	0	0
01110	Të ardhurave te trashëguara	19530000	34343000	57527469
01160	Transferta të kushtëzuara DAMT	5967000	6920000	6770000
	<b>Të ardhurat gjithsej</b>	<b>82029773</b>	<b>90415437</b>	<b>121587074</b>

Sipas udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr 6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e tavanëve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021” dhe VKQ nr 13 datë 18.12.2017 “Mbi miratimin e Buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2018” u bënë llogaritjet për transfertat e pakushtëzuara dhe të kushtëzuara. Ky udhëzim përcaktonte rritjen e transfertës së pakushtëzuar në vlerë, jo në përqindje si ishte llogaritur vitet e kaluara. Duke u mbështetur në këtë udhëzim u bënë llogaritjet për tre vitet në vazhdim për vitin 2019 transferta e pakushtëzuar është 50,542,576 lekë, për vitin 2020 transferta e pakushtëzuar është 51,595,546 lekë dhe për vitin 2021 transferta e pakushtëzuar është 52,648,517 lekë. Po ti konvertosh në përqindje këto vlera, rritja nga viti në vit është mesatarisht 2%.

Grupi diskutoi rreth buxhetit, burimeve financiare për tre vitet e ardhshme, të përbërë nga transferta e pakushtëzuar, të ardhurat e vet institucionit nga shërbimet që ofron dhe të ardhurat nga kontributi financiar i Bashkive. Pjesë e diskutimit ishin dhe projekt idetë për aktivitete që do të planifikohen në vitet në vazhdim me synim arritjen e objektivave të Keshillit të Qarkut. Në lidhje me të ardhurat e veta GMS u mbështet në realizimin e të ardhurave të vitit 2017, si shërbimet që ofron K. Qarkut dhe realizimi i kontributit financiar të Bashkive sipas realizimit të të ardhurave të tyre.